

USE OF THE TERM „FSHAT” AGAINST „KATUND” IN KOSOVO AND THEIR SEMANTIC BACKGROUND

PËRDORIMI I TERMIT „FSHAT” KUNDRRUAL „KATUND” NË KOSOVË DHE SFONDI SEMANTIK I TYRE

Labinot KRASNIQI¹

Përmbledhje

Në këtë punim kemi bërë një hulumtim në terren sa i përket përdorimit të termit “fshat” kundrrual “katund” në Kosovë, si dhe kemi parë sfondin semantik të këtyre dy sinonimeve në popull. Gjatë këtij hulumtimi kemi kontaktuar me persona të viseve të ndryshme të Kosovës, nga të cilët jemi munduar të mësojmë se cilën nga këto dy sinonime ishin të prirur ta përdornin kur donin të flisnin në standard, si dhe i kemi pyetur nëse për ta ka ndonjë nuancë dallimi ndërmjet këtyre dy fjalëve. Gjatë hulumtimit në terren i kemi incizuar intervistat, të cilat pastaj i kemi analizuar, një nga një. Këtë punim e kemi ndarë në tri pjesë.

Në pjesën e parë kemi sfondin teorik të punimit, ku është bërë një hyrje e shkurtër rreth studimeve sociolinguistike sa i përket përzgjedhjes gjuhësore të folësve të ndryshëm. Pjesa e dytë e punimit trajton metodologjinë, hipotezat dhe qëllimin e këtij punimi. Në pjesën e tretë janë trajtuar analizat dhe rezultatet e hulumtimit. Në fund kemi nxjerrë se cila nga këto dy fjalë ka prirje për t’u përdorur më tepër si fjalë standarde në popull, si dhe a kanë ndonjë dallim këto dy fjalë semantikisht apo jo.

Fjalët kyçe: *fshat, katund, kuptimi leksikor, standard.*

1. Sfondi teorik

Si njerëz, ne jemi të gatshëm t’i ndërrojmë sjelljet tona. Çdo fjalë që themi, na bind se ne i përzgjedhim fjalët kur flasim. Aftësia për t’i pasur parasysh mundësitë e përzgjedhjes së fjalëve është jetike për neve. Me këtë fushë merret më së shumti sociolinguistika. Sipas Coulmas (2005), “Sociolinguistika është gjuhësia e përzgjedhjes, andaj, qoftë edhe vetëm për këtë arsye duhet ta lidhim këtë me marrëdhënien e lirisë së vullnetit, veprimit njerëzor dhe gjuhës...”. Të zgjedhësh fjalët para se të dish se çfarë do të thuash, na bënë të dijmë e të reflektojmë se çfarë është gjuha. Pika e rëndësishme është se bërja e përzgjedhjes është një pjesë qendrore e të qenit njeri. Edhe foshnjat bëjnë përzgjedhjen e tyre kur nisin jetën e tyre.

Fëmijët shpesh herë ndikohen nga rrethi se çfarë të përzgjedhin. Si rrjedhojë, ne shpeshherë ndikohemi nga disa barriera të ndryshme që na janë pjekur se nuk duhet t’i bëjmë që në fëmijërinë tonë. Përzgjedhjet bazohen në gjykimet tona, të cilat nuk është se i kontrollojmë çdo herë. Gjykimet rrjedhin nga interpretimet e mundshme, sipas besimeve dhe përzgjedhjeve të individëve, të cilët mund të kenë mungesë të të dhënave.

Një faktor i përzgjedhjes gjuhësore është shtresa shoqërore, të cilët flasin sipas zonës dialektore që i përkasin. Dallimet dialektore dihen që kur kanë filluar të ruhen vrojtimit e bëra gjuhësore. Sociolinguistika është zgjeruar në shumë fusha, por qasjet dialektore, sociale, përbëjnë studimet kryesore të kësaj disipline. Sa i përket përzgjedhjes gjuhësore, Trudgill (2000) thotë se situata shoqërore është një faktor që përcakton se çfarë do të zgjedhë për të folur një person. Sërish, Trudgill (2000) pohon se “Përzgjedhja e gjuhës, nga ana tjetër, gjithashtu mund të përdoret për të treguar gjendjet dhe synimet tona të veçanta...”

Ndryshimet në të folur janë të vërteta gjuhësore. Meqenëse, në bazë, sociolinguistika merret me raportet midis gjuhës dhe shoqërisë, vërejtjet në variantet gjuhësore janë qendrore: ato çojnë në të kuptuarit më të mirë të këtyre raporteve, duke ndriçuar ndryshimet që ndodhin në të gjitha gjuhët. Edward (2013) e klasifikon punën sociolinguistike në disa mënyra: “Puna sociolinguistike në terren mund të jetë e drejtpërdrejtë, duke u kërkuar njerëzve të thonë gjëra që kanë karakteristika të përbashkëta gjuhësore, mund të jetë një hulumtim, ku kërkohen dallimet e fjalorit nëpër rajone, ose mund të jetë pak më delikate”. Hulumtuesit mund të dëgjojnë, të regjistrojnë dhe të ri-dëgjojnë sipas nevojës.

Holmes (2015) pohon se “... kur njerëzit bisedojnë me njëri-tjetrin, ligjërimi i tyre bëhet më i ngjashëm”. Me fjalë të tjera, ligjërimi i çdo personi konvergon me ligjërimin e personit me të cilin ai bisedon. Këtë proces, Holmes e quan *përshtatje ligjërimore* dhe ndodh zakonisht kur folësit e pëlqejnë njëri tjetrin ose kur njëri prej folësve e ka si qëllim në vetvete që ta kënaqë tjetrin apo ta bëjë të ndihet mirë. Konteksti shoqëror ku zhvillohet komunikimi, ndikon në mënyrën se si flasin njerëzit. Është e rëndësishme se kush po na dëgjon, ku po flasim dhe si ndihemi. I njëjti mesazh mund t'u shprehet në mënyra shumë të ndryshme njerëzve të ndryshëm. Ne përdorim stile të ndryshme në kontekste shoqërore të ndryshme. Shqyrtimi i mënyrës se si e përdorin njerëzit gjuhën në kontekste të ndryshme shoqërore, na jep mjaft informacion.

Hapi i parë për të kuptuar se çfarë zgjedhesh janë të mundshme për folësit, Romaine (2000) thotë se është të nxjerësh ide se cilat gjuhë dhe varietete janë të disponueshme për ta në një kontekst të veçantë shoqëror. Konteksti në këtë rast mund të konsiderohet në kuptimin e tij më të gjerë, pasi varietetet e vëna në dispozicion mund të jenë zyrtarisht ose jozyrtarisht brenda kufijve të një shteti, ose në një kuptim shumë të ngushtë, si varietetet e disponueshme në një rast të veçantë. Wardhaugh (2006) pohon se secili grup ka normën e vet gjuhësore. Ligjërimi përdoret në mënyra të ndryshme midis grupeve të ndryshme të njerëzve. Secili grup apo edhe person ka normat e veta të sjelljes gjuhësore.

Grupe të ndryshme të njerëzve përdorin gjuhën e tyre asisoj sa që ne mund të arrijmë një kuptim gjithëpërfshirës se si e flet ai person atë gjuhë. Një shoqëri që inkurajon një shumëllojshmëri të gjerë fëmijësh ose bisedimesh ka të ngjarë të jetë mjaft ndryshe në shumë mënyra jogjuhësore. Është shumë e thjeshtë për të shpjeguar zgjedhjet gjuhësore që i bëjnë folësit, pohon prapë Wardhaugh (2006). Është në thelb një qasje një dimensionale ndaj një situatë në të cilën të gjithë faktorët sugjerojnë se një qasje multi-dimensionale mund të ofrohet për sjelljen e duhur gjuhësore.

Disa nga faktorët që ndikojnë në përzgjedhjet gjuhësore Wardhaugh i përmbledh kështu: “Ne do të shikojmë kryesisht në fenomenin e ndryshimit të kodit në situata dygjuhëshe dhe shumëgjuhësore. Megjithatë, shumë nga çështjet që ne do të shohim gjithashtu lindin me ato që mund të quhen nën-variacione të një gjuhe të vetme, p.sh. dialektet, stilet dhe regjistrat. Në veçanti, ne do të shqyrtojmë të ashtuquajturën situatë diglosi, në të cilën dallimet e qarta funksionale midis kodeve qeverisin zgjedhjen.” Ai ndërrimin e kodit e sheh si një faktor shumë ndikues në përzgjedhjet gjuhësore. Hulumtimi që kemi bërë ne, ka karakter sociolinguistik dhe trajton si i tillë përdorimin e termit “fshat” kundrruall “katund” të folësit të Kosovës si dhe sfondin semantik të tyre. Këtu kemi të bëjmë me një përzgjedhje të fjalëve që bëjnë personat të ndryshëm.

Kuptimet e këtyre termave në fjalorët e ndryshëm shpjegues të shqipes jepen të njëjtë (trajtohen si sinonime), megjithatë folës të ndryshëm të shqipes i dallojnë këto dy fjalë semantikisht. Fjalori i '54-ës për fjalën katund jep të njëjtat shpjegime sikurse për fjalën fshat: *vend më i vogël se qyteti, ku banojnë kryesisht fshatarë; katund*. Edhe fjalori i '80-ës dhe i 2006-ës japin të njëjtat shpjegime. Megjithatë fjalori i 1980-ës dhe i 2006-ës te shpjegimi i dytë i kësaj fjale si term në kuptimin e fushës së historisë japin një kuptim pak të ndryshëm për fjalën katund: *Bashkësi e njerëzve, që merreshin kryesisht me blegtori e bënë një jetë shtegtare; vendbanimi i përkohshëm i këtyre njerëzve; fshat i madh, me shtëpi të shpërndara e larg njëra-tjetrës*.

Sipas Çabejt (1986) “Përndarja dialektore e sinonimeve *fshat* e *katund* është kjo, që në vijë të përgjithshme *fshat* mbizotëron në toskërishten, *katund* në gegërishten. Kjo sigurisht ka lidhje me historinë kulturore të vendit, veçanërisht me mënyrën e banimit (sh. për këtë edhe Sufflay, Serbët dhe Shqiptarët 89vv): Toskëria më fot në aglomerate shtëpish grumbulluar në lagje e në katunde, Gegëria më shpesh në shtëpi të veçuara, rrethuar me gardhiqe e me ograqe, me gjithë se nuk mungon tipi i parë këtu, i dyti atje. Kështu pra ndryshimi i emrit pasqyron një ndryshim realiesh, përndarja gjuhësore një përndarje etnografike e sociale.”

Në fjalorin etimologjik të Topallit (2017), njësia “*katund*” shpjegohet si fjalë e mbarë gjuhës duke përfshirë edhe arb. e Italisë e të Greqisë, por me njëfarë përndarjeje të pabarabartë dialektore, duke u përdorur më fort në gegërishte e më pak në toskërishte, ku mbizotëron *fshat*. Shpjegimin e parë etimologjik të kësaj fjale e bën Miklosich-i, sipas të cilit vjen nga italishtja “*cantone*” (krahinë). Ky shpjegim është mbështetur edhe nga studiuesit e mëvonshëm si Çabej (2014) e Topalli (2017).

Krahas kësaj edhe njësia “*fshat*” te fjalori etimologjik i Topallit (2017) shpjegohet gjithashtu si fjalë e mbarë shqipes, por me mbizotërim në dialektin e Jugut; më pak e përdorur në Veri, ku mbizotëron *katund*. E kanë edhe arbëreshët e Italisë e të Greqisë. Sa i përket etimologjisë së kësaj fjale, shpjegohet në dy mënyra. Nëse merret si fjalë e shqipes lidhet me *fushë*, që ka marrë prapashtesën *-at*, duke u dalluar *fshati*, që përgjithësisht është në fushë me shtëpi të grumbulluara, nga mali, që përgjithësisht është me shtëpi të veçuara. Mendimi tjetër, i cili nuk gjen mbështetje nga Topalli, është mendimi i Joklit, mbështetur poashtu edhe nga Çabej, të cilën e lidhin me *çaj* e me *shat* (f-shat).

Sipas Çabejt “Në të vërtetë *fshat* është *f-shat* dhe etimologjikisht identik me *shat*-in e bujqësisë. Kuptimi i përbashkët i të dy fjalëve është “ndarje, veçim”. Pastaj u krye një bigëzim formash e domethëniesh: *shat* e *fshat* secila me kuptimin e vet.” Ajo që kemi bërë ne, ka qenë një hulumtim që kemi bërë me persona që vijnë nga vise të ndryshme të Kosovës. Kemi bërë disa kërkime se folësit e Kosovës, a përdorin më tepër termin “*fshat*” apo “*katund*” kur janë të prirur të flasin në standard, si dhe a i dallojnë këto dy njësi leksikore semantikisht.

Sipas shpjegimeve të fjalorëve të ndryshëm të shqipes, këto dy njësi janë të njëjta, por ne kemi hasur te disa folës, që t’i dallojnë këto dy njësi semantikisht, duke e konsideruar termin “*katund*” si vendbanim me pak shtëpi, të cilat janë larg njëra tjetrës dhe gjenden në vise më malore, ndërsa atë “*fshat*” e konsiderojnë më tepër si vendbanim fushor. Ky shpjegim përkon me shpjegimin e Fjalorit të Gjuhës së Sotme Shqipe (1980) në kuptimin e dytë që e jep si term historik, gjithashtu edhe me shpjegimet etimologjike, sidomos të Çabejtë (1986).

Kështu që, ne kemi hulumtuar se cilët folës më tepër i bëjnë këto dallime, të moshuarit apo të rinjtë, si dhe të shohim se pse mendojnë se ato dy fjalë kanë ndryshime mes veti dhe se sa të përafërta me shpjegimet e fjalorëve janë shpjegimet që jepen nga folësit. Këtë punim e kemi bërë nëpërmjet intervistave, nga të cilat në fund i kemi nxjerrë rezultatet, të cilat nuk kanë dalë edhe shumë sipas pritshmërive dhe parashikimeve tona, sipas të cilave folësit, fjalën “*katund*” thuajse nuk e dallojnë fare nga ajo “*fshat*”, ndërsa si fjalë standarde në përgjithësi e kanë përdorur termin “*fshat*” kundrrual atij “*katund*”.

2. Qëllimi, hipotezat dhe metodologjia

Qëllimi i këtij punimi është që të mësojmë se cilën nga këto dy fjalë, pra “katund” dhe “fshat”, njerëzit janë të prirur ta përdorin kur duan të flasin në standard. Qëllimi tjetër i këtij hulumtimi është të mësojmë se a dallojnë këto dy fjalë semantikisht në popull, nëse po çfarë dallimi kanë këto njësi për ta. Ky hulumtim do të bëhet me persona të moshave të ndryshme. Do të shohim nëse të rinjtë apo të moshuarit janë duke i dalluar këto njësi. Me anë të këtij punimi synojmë t’i japim lexuesit një pasqyrë të shkurtër rreth përdorimit të këtyre sinonimeve në të folmen e Kosovës, pra asisoj sa që lexuesi ta ketë të qartë se cilat janë dallimet semantike të këtyre fjalëve sipas shqiptarëve të Kosovës, si dhe cila nga këto dy fjalë konsiderohet standarde sipas tyre.

Hipotezat e punimit janë:

a. Folësit e Kosovës, kur flasin standard, më tepër përdorin fjalën “fshat” kundrruall asaj “katund”, dhe këtë të fundit nuk e konsiderojnë të normëzuar.

b. Fjala “katund” semantikisht dallon nga fjala “fshat” sipas shqip folësve të Kosovës.

Pyetjet hulumtuese të punimit janë:

a. A e përdorin folësit e Kosovës më tepër fjalën “fshat” apo “katund” kur duan të flasin në standard?

b. A dallon semantikisht fjala “fshat” kundrejt asaj “katund” nga folësit e Kosovës?

Ky punim është një hulumtim në terren, andaj metoda që do të përdorim gjatë këtij punimi është intervista me persona të ndryshëm. Paraprakisht do hulumtojmë edhe shpjegimet që jepen për këto dy fjalë në fjalorët shpjegues dhe në fjalorët etimologjikë. Në fund do të nxjerrim rezultatet e hulumtimit në punim me shkrim.

3. Rezultatet dhe gjetjet

3.1. A përdoret më tepër termi “fshat” apo “katund” në standard?

Sa i përket qëllimit të studimit të kësaj dege të sociolinguistikës, përkatësisht “gjeografisë gjuhësore” në dialektologji, Hudson (2004) pohon se është krahasues: të krahasohen me njëri tjetrin tekstet ose njerëzit. Çdo ndryshore e paracaktuar na jep një dimension të dalluar mbi të cilin mund të krahasohen tekstet. Procesi i formimit të gjuhës standarde shqipe ka nisur kryesisht nga motivet nacionaliste dhe atdhetare, motive të cilat, në të shumtën e rasteve, janë motive shtytëse në të gjitha aktivitetet për formimin e gjuhëve standarde (Munishi, 2013).


Por gjatë përdorimit të disa fjalëve nga populli, me mendimin se njëra fjalë është në standard ndërsa e vetja jo, duke u bazuar nga një intuitë e brendshme, ose duke parë dikë tjetër që flet një dialekt më në prestigj, mendon se fjala që përdoret në të folmen e tij nuk është normëzuar, andaj fillon të mos e përdor kur do të flasë në standard. Njëjtë mendoj se ka ndodhur edhe me termin *katund*, që përdoret më shumë në gegërisht. Folësit e gegërishtes nuk e konsiderojnë këtë fjalë standarde. Në rastin tonë ne kemi marrë dhjetë regjistrime të njerëzve të ndryshëm që flasin në rrethana të ngjashme. Pastaj i kemi shqyrtuar tekstet e regjistruara.

Nga dhjetë intervistues që janë gjithsej, vetëm njëri prej tyre ka thënë se përdor termin “katund” në vend të “fshat”, ndërsa nëntë të tjerët, shtatë prej tyre meshkuj e dy femra, përdorin termin “fshat” kundrruall atij “katund” kur flasin në standard. Gjashtë nga të intervistuarit janë me shkollim të lartë dhe kanë profesione të ndryshme. Prej tyre kemi mësues, juristë, gjuhëtarë, tregtarë dhe studentë, ku shumica janë mësues me 40 %. 10 % janë tregtarë, 10 % juristë, 20 % studentë dhe 20 % punëtorë. Ai që përdor “katund” është me shkollim të mesëm, dhe është punëtor. Sipas të cilit gjithashtu nuk ka ndonjë dallim ndërmjet “katund” dhe “fshat”. Më poshtë po japim tabelën e statistikave sipas të dhënave personale.

	GJITHSEJ	Femra	Meshkuj	Shkollimi		Profesioni			
				I lartë	Mesm	Mësues	Tregtar	Stud	Jurist
Fshat	90%	30%	70%	70%	30%	40%	10%	20%	10%
Katund	10%		100%		100%				

Tabela 1.

Sa i përket moshave të tyre, kemi prej moshës 20 vjeçare e deri në moshën 60 vjeçare. Katër prej tyre janë mbi 40 vjeçar. Gjashtë të tjerët nën 40, dy prej tyre edhe studentë të rinj janë. Mesatarja e moshë është rreth 35 vjeçare. Të intervistuarit vijnë nga vende të ndryshme. Kemi nga Dragashi, Podujeva, Malisheva, Gjilani, Kamenica dhe Rahoveci. 30 % janë nga Gjilani, 20 % nga Podujeva, 10 % nga Mitrovica, 10 % nga Rahoveci, 10 % nga Dragashi dhe 10 % nga Malisheva. Intervistuesi që përdor “katund” kundrrual “fshat” është nga Podujeva. Më poshtë po japim një grafik me statistika sipas përqindjes së qyteteve.



Grafiku 1.

3.2. A dallon semantikisht fjala “fshat” kundrejt asaj “katund” nga folësit e Kosovës?

Sistemi semantik leksikor dhe analiza semasiologjike nuk mund të kuptohen pa disa kategori themelore të semantikës, si kuptimi, lëvizja kuptimore dhe struktura e kuptimit. (Thomai, 2006). Më poshtë kemi rezultatet e hulumtit sa i përket kuptimit të termave të kërkuar. 60 % e të intervistuarëve kanë thënë se këto dy fjalë janë të njëjta dhe nuk kanë kurrfarë dallimi mes tyre. Ndërsa 40 % të tjerë kanë mëtuar se ndryshojnë mes veti këto dy fjalë. Prej atyre që kanë thënë se ndryshon të katërtit janë meshkuj. Njëri nga ta është student. Tre prej tyre të pjekur: një tregtar, një jurist dhe një punëtor me shkollë të lartë.

Sa i përket moshave të tyre, studenti është 19 vjeçar, ndërsa të tjerët janë mbi 50 vjeçar. Nga ata që kanë thënë se nuk ndryshojnë, katër janë meshkuj, dy femra. Përpos njëres që ka mbi 50 vjet, të tjerët janë nën 40 vjet. Prej tyre njëri është student, të tjerët me shkollim të lartë. Më poshtë kemi tabelën e statistikave me përqindje:

	GJITHSEJ	Femra	Meshkuj	Shkollimi		Profesioni				
				I lartë	Mesme	Mësues	Punëto	Treg	Jurist	Stude
Ndryshon	40%	0%	100%	50%	50%	0%	30%	30%	20%	20%
Nuk ndryshon	60%	35%	65%	65%	35%	50%	30%			20%

Tabela 2.

Nga ata që kanë thënë se këto dy terma ndryshojnë mes veti janë nga Kamenica, Gjilani, Rahoveci. Ndërsa prej atyre që kanë thënë se nuk ndryshojnë janë nga Gjilani, Dragashi, Mitrovica, Malisheva dhe Podujeva. Më poshtë po japim dy harta për statistikën sipas vendlindjes së anketuesve. Harta e parë është për ata që thonë se gjuha standarde duhet të ndryshojë, ndërsa e dyta për ata që thonë se nuk duhet të ndryshojë.

Nga ndryshimet që kanë cekur të intervistuarit janë këto:

- *Katundi është në vend më malor ndërsa fshati është më i rrafshët (Këtë ia paskësh thënë arsimtari i Historisë)*
- *Në katund shtëpitë janë më të rralla nga njëra tjetra dhe janë më nëpër male.*
- *Katundi ka më pak shtëpi dhe i ka më larg njëra tjetrës.*
- *Gjenerata e vjetër i thonë katund, ndërsa gjenerata e re i thonë fshat.*

Sa i përket fjalëve të hulumtuara te disa folës të pakët duket se ka pasur lëvizje kuptimore te atyre dy termave, duke e dalluar atë *fshat* nga tjetra *katund*. Thomai pohon se “Burimi i fjalëve në etimologji kërkohet duke ndjekur dy vija: duke zbuluar lidhjet e formave të sotme të fjalës me ato të hershmet deri te gjuha mëmë ose gjuha e huaj (kur ka burim të huaj) dhe duke ndjekur lëvizjen e kuptimit nga ai më i hershmi deri tek i fundit” (Thomai, 2006). Dallimi semantik që jepet në shpjegimet etimologjike ndërmjet këtyre dy termave, duket se gjën zbatim edhe në përdorim në popull.

Përfundime

Si rezultat i këtij punimi do t’i përmbledhim këto përfundime:

Më shumë se gjysma e të intervistuarëve (90 %) kanë përdorur termin *fshat* në vend të atij *katund* kur flisnin në standard. Kështu kanë qenë edhe pritshmëritë tona, kur kemi ngritur hipotezën. Vetëm një person, me shkollë të mesme, nga Podujeva, përdorte termin *katund* në standard. Sa i përket sfondit semantik të termit *fshat* me atë *katund*, më shumë se gjysma (60 %) thanë që janë të njëjta, pjesa tjetër (40 %) thanë që ndryshojnë. Megjithatë pritshmëritë kanë qenë që më shumë se gjysma të mendonte se ndryshojnë, megjithatë u vërtetua e kundërta e hipotezës që kemi ngritur në fillim.

Pjesa e atyre që mendonin se këta dy terma ndryshojnë dhanë disa shpjegime. Njëri prej tyre tha që kështu i kishte thënë arsimtari i historisë, gjë që bie në përputhje me shpjegimin nr. 2 që jepet në Fjalorin e Gjuhës së Sotme Shqipe (1980), në të cilin nr. kjo fjalë shpjegohet si term i historisë, ku *katund* nënkupton një *bashkësi të njerëzve, që merreshin kryesisht me blegtori e bënin një jetë shtegtare; vendbanimi i përkohshëm i këtyre njerëzve; fshat i madh, me shtëpi të shpërndara e larg njëra-tjetrës*.

Përafërsisht është dhënë shpjegimi i njëjtë (sipas fjalorit) nga të intervistuarit që mendonin se *katund* dallon nga *fshat*, megjithatë në studimet tjera do të duhet të analizohet më mostër më të gjerë, si dhe duke i studiuar shpjegimet etimologjike nga të gjitha studiuesit që kanë dhënë shpjegime për këta dy terma. Ata që kanë thënë se *katund* ndryshon nga *fshat* kanë qenë të moshës së vjetër, mbi 50 vjet, gjë që na bën të ditur se ky mendim për këto dy koncepte më shumë duket se është shpërndarë nga gjenerata e vjetër.

Referencat

- [1]. Çabej, E. (1986). *Studime gjuhësore I*. Prishtinë: Rilindja.
- [2]. Çabej, E. (2014). *Studime etimologjike në fushë të shqipes V*. Tiranë: Çabej.
- [3]. Coulmas, F. (2005). *Sociolinguistics: The study of speakers' choices*. New York: Cambridge University Press.
- [4]. Edward, J. (2013). *Sociolinguistics: A Very Short Introduction*. New York: Oxford University Press.
- [5]. *Fjalor i gjuhës së sotme shqipe*. (1980). Tiranë: Akademia e Shkencave e RPS të Shqipërisë.
- [6]. Holmes, J. (2015). *Hyrje në sociolinguistikë*. Tiranë: Botime Pegi.
- [7]. Hudson, R. (2004). *Sociolinguistika*. Tiranë: Dituria.
- [8]. Munishi, S. (2013). *Probleme të shqipes standarde në Kosovë*. Prishtinë: AIKD-99.
- [9]. Romaine, S. (2000). *Language in Society: An introduction to Sociolinguistics* (2nd ed.). New York: Oxford University Press.
- [10]. Thomai, J. (2006). *Leksikologjia e gjuhës shqipe*. Tiranë: Toena.
- [11]. Topalli, K. (2017). *Fjalor etimologjik i shqipes*. Tiranë: Qendra e studimeve albanologjike.
- [12]. Trudgill, P. (2000). *Sociolinguistics: An Introduction to Language and Society* (4th ed.). England: Penguin Books.
- [13]. Wardhaugh, R. (2006). *An Introduction to Sociolinguistics* (5th ed.). United Kingdom: Blackwell Publishing.